



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:256342

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05595103

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.I., nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1 nën. par.1.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë PP/II.nr.1604/23 të datës 28.12.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **18.04.2024**, në prani të Prokurorës së shtetit Shqiponja Jupa të dëmtuarit P.L., mbrojtësit të akuzuarit sipas detyrës zyrtare Korab Bokshi dhe të akuzuarit F.I., me datën 19.04.2024, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **F.I.**, nga Gjakova Rr.”. “, i lindur me dt. ... i biri i .... dhe i nënës ... e gjinisë ..., analfabet di vetëm emrin me e shënua, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar atë i një fëmijë, rom, shtetas i R. Kosovës, me ID ...

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:**

- me datë 17.02.23 rreth orës 14:00 min, në fshatin ... K.Gjakovë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, me përdorim të forcës me mjet-shufër metalike depërton në shtëpinë e të dëmtuarit P.L., dhe nga aty merr një Ipad të firmës Apple, një orë dore të firmës Rado, një orë dorë të firmës M Watch, një orë dorë të firmës Ferruci, një bateri dore të firmës Wurth, një byzylyk dorë, një valixhe, si dhe veshje tradicionale, në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike më përdorim të shufrës metalike hap derën e hyrjes së shtëpisë e të dëmtuarit, depërton brenda, dhe nga aty merr sendet e lartcekura, i fut ato në valixhe, dhe me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes.

**-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-ës.**

Gjykata në kuptim të neneve 2, 3, 4, 6, 7, 17, 38, 39 par. 1.nën par.. 1.1, nenit 40 par. 1. nën par. 1.2, neneve 42,43, 69, 70, 72 par. 1, nën par. 1.3, si dhe nenit 315 par.1 nën. par.1.1 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e :

**G J Y K O N**

**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 viteve**, si dhe

**DENIM ME GJOBË** në shumë prej **300 (treqind ) euro**, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00 .-€ (njëzet)** euro të gjobës.

I dëmtuari P.L., nga fsh. ... Komuna Gjakovë , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet procedurale bien ne barrën e mjeteve buxhetore.

## **A r s y e t i m**

### *1.Ecurija e procedurës penale*

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1604/23 të datës 28.12.2023 ka akuzuar të akuzuarin F.I., nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e rendë nga neni 315 par.1 nën. par.1.1 të KPRK-ës

Prokurorja e shtetit Shqiponja Jupa s , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 18.04.2024 , lexon aktakuzën PP/II.nr.1604/23 të datës 28.12.2023 dhe deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari F.I., , gjatë e shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij av. Blerina Kurtaj deklaron e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Korab Bokshi deklaron: ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem , kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet e mija të cilat i ka kryer nen ndikimin e lendeve narkotike , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet me qe jam ne vuajtje te dënimit për vepra penale te natyrës se njëjti , i cili ka ndikuar tek unë qe te risocializohem, sa jam ne dijen gjerat e vjedhura i janë kthyer te dëmtuarit , andaj gjykatës i propozoi te me shqiptojë një dënim me te butë .

Mbrojtësi av. Korab Bokshi deklaroi se këtu i akuzuari Fatmir sot deklarimin e tij e ka dhënë me vullnet te plote dhe ky deklarim është faktikisht konfirmimi i deklarimeve te mëhershme te tija te dhëna ne polici dhe prokurori ,e po ashtu konsiderojë qe pranimi i fajësisë është edhe ne përputhje me provat materiale në te cilat mbështet aktakuza. Në cilësi te mbrojtësit te akuzuarit i kam sqaruar pasojat dhe benefitet e pranimi te fajësisë ,dhe siç theksova me lartë i njëjti i penduar thellë deklaroi se e pranon fajësinë , pa dilemë dhe me keqardhje për te dëmtuarin .Në kuptim te këtyre deklarimeve konsiderojë qe pranimi i fajësisë duhet te trajtohet si i rregullt dhe i ligjshëm . Lidhur deklaroi se duke marr parasysh që gjykata aprovojë pranimin e fajësisë këtu te akuzuarit Fatmir , gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese ne rastin e matjes se llojit te lartësisë se dënimit , e te cilat rrethana janë fakte qe këtu i akuzuari ka pranuar fajësinë që nga koha kur është paraqitur ne polici, pastaj ne prokurori dhe sot te njëjtën e konfirmojë edhe para gjykatës .Po ashtu si rrethanë lehtësuese te merret parasysh edhe kthimi i gjësendeve qe janë gjendur përkatësisht i ka dorëzuar i akuzuari , i cili veprim zvogëlon sado pak pasojën e veprës penale te kryer nga i akuzuari , e po ashtu te merret parasysh edhe rrethana se ne momentin e kryerjes se veprës penale i akuzuari ka qenë ne një gjendje te keqe shpirtërore ,i varur nga substancat narkotike ,e qe për pasoj ka shtyre te njëjtin ne ndërmarrjen e veprimeve te përshkruara ne aktakuzë. Gjithashtu gjykata duhet te merr

parasysh edhe rrethanat familjare të tija , se i njëjti i nevojitet familjes posaçërisht fëmijës së tij të i sigurojë mbajtje dhe jetës të sigurt. Konsiderojë se sot gjatë deklarimit të akuzuarit theksojë se është në vuajtje të dënimit për një veprë tjetër penale të ngjashme, andaj gjykatës i propozoi që në kuptim të nenit 78 të KPRK-së, të akuzuarit të llogaritet edhe dënimit paraprake dhe të shqiptohet një dënim unik.

I dëmtuari P.L., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë , i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe kërkon kompensim demi të cilën do ta realizojë në kontest civil.

Prokurori i shtetit Shqiponja Jupa deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bere nga ana e të akuzuarit F.I., pasi që pranimi i fajësisë është bere pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av.Korab Bokshi ,pranimi i fajësisë është bere vullnetarisht ,pa presion , duke i ditur pasojat dhe benefitet e një pranimi të tillë ,pranimi i fajësisë ka mbështetjeje në provat materiale dhe personale që i janë bashkangjitur aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje dhe gabim faktik ,andaj gjykatës i propozoi që të aprovohet pranimi i fajësisë . Lidhur me vendimin i propozoi gjykatës që me gjykata morri aktvendim për pranimin e fajësisë për këtu të pandehurin F.I., , i propozoi gjykatës që me rastin e caktimit të llojit të lartësisë se dënimit duke vepruar konform dispozitave se nenit 70 par.2 dhe 3 të KPPRK-s., si rrethanë lehtësueses të merret pranimi i fajësisë se bere nga ana e të pandehurit , ndërsa si rrethanë renduese të merret parasysh shkalla e lartë e dashjes për kryerjen e veprës penale , dënimet e me parme të personit të akuzuar , pasi që prokurori i shtetit e ka verifikuar të kaluarën kriminale të pandehurit F.I., , ku nga regjistri i ZQEPKGJK, rezulton se i pandehuri është i dënuar me aktgjykime të formës së prerë : P,nr. 341/2020 dt. 01.07.2021,P.nr. 28/21 dt.07.10.2021,P.nr. 199/21 dt. 05.11.2021,P.nr. 234/21 dt. 22.11.2021 ,P.nr. 463/22 dt.03.04.2023 ,2023:070131 dt.29.05.2023si dhe 2023:065809 dt.29.06.2023.,per çka janë vepra penale të natyrës së njëjtë vjedhje , vjedhje e rende. Andaj i propozoi gjykatës që me rastin e vlerësimit të kësaj rrethanë renduese në mbështetje të nënti 69 par. 4 të këtë parasysh dispozitën ligjore kur e cakton dënim për recidivist , merr parasysh kur kryesi me parë ka kryer veprën penale të njëjtë sikurse veprën e re, për çka në rastin konkret kemi disa vepra të natyrës së ngjashme dhe i pandehuri ka përsëritur veprën e njëjtë.

## 2.Vlersimi pranimi të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjyquese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari F.I., , për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 315 par.1nen par. 1.1 të KPRK-së, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Korab Bokshi edhe nga ana e gjykatës, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 par. 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtë aktgjykimi dhe për këtë

ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykon në bazë të ligjit ,me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij .

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 313 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vjedhjes e kryen: *“Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej (50) euro apo më shumë , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër , dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre(3 ) vjet.*

Ndërsa në nenin 315 par. 1 të KPRK-së është paraparë forma më e rënd e kësaj veprë e cila parasheh se *:.Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 313 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse: 1.1. vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme.*

#### 5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin F.I., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes se rëndë nga neni 315 par.1 nën par. 1.1 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ku sa i përket rrethanave rënduese, gjykata në rastin konkret pati parasysh karakteristikat e tij personale, i cili është recidivist, pasi që i njëjti edhe më parë nga evidenca penale për të akuzuarin të lëshuar nga ana e kësaj gjykate evidentohet me këto lëndë penale : P.nr.341/20 - neni 185 dhe 184 - Dënim me burg 8 muaj - PF.01.07.2021 ;P.nr.28/21 - neni 313 - Dënim me burg 60 ditë dhe gjobë 200 euro - PF.07.10.2021 ;P.nr.199/21 - neni 248 - Dënim me burg 7 muaj dhe gjobë 200 euro - PF.05.11.2021;P.nr.234/21 - neni 185 - Dënim me burg 180 ditë - PF.22.11.2021;P.nr.463/22 - neni 313 - Dënim me burg 90 ditë - PF.22.03..2023: P.nr.2023:070131- 313/1-dënim me burg 120 ditë dhe gjobë 300 euro i Pf.29.05.2013.; P.nr.2023:065809- 313/1- dënim me burg 3 muaj dhe gjobë 100 euro - i Pf.29.06.2013., por i njëjti nuk është ri socializuar dhe se dënimet e shqiptuara nuk e kanë arritur qëllimin e tij , por ka përsëritur veprën penale të natyrës së njëjtë , mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale , dashjen e tij të lartë për kryerjen e kësaj veprë penale , ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti personalitetin e tij , është baba i 1 fëmije, pranimin e fajësisë të cilin e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale si në polici, prokurori dhe gjatë shqyrtimit fillestar, të dëmtuarit i ka kërkuar edhe falje publike, sjelljen korrekte në gjykim kthimi i gjësendeve që janë gjendu dhe t[ cekura në aktakuzë , i gjendjes së tejet të dobët ekonomike, është penduar për veprën e kryer, ka shpreh keqardhje për veprimet e veta, si dhe i njëjti ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryen vepra të tilla penale apo të ngjashme, andaj gjykata duke u bazuar në të gjitha këto rrethana ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet për zbutjen e dënimit të parapara ne nenin 72 par.1 nën. par.1.3 të KPRK-ës, gjykata te akuzuarit i shqiptojë dënimin nën minimumin e paraparë ligjor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se me shqiptimin e dënimit me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy ) vite si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind ) euro, është dënim i drejtë, duke pas parasysh rrethanat e krijuara, është harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i tij, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston me parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprës penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin P.L., , për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht, të kërkesës pasurore juridike .

#### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje te nenit 452 par.4 te KPP-ës ,pasi që akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështes materialisht.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
2023: 256342 me datë 19.04.2024**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.